

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

27 tetor 2009
Prishtine
Ap.-Kz Nr. 345/08

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë prej Gjyqtarit ndërkombëtar Emilio Gatti si Kryetar i kolegjit, Gjyqtarit ndërkombëtar Gerrit-Marc Sprenger dhe Gjyqtarit Kosovar Avdi Dinaj si anëtarë të kolegjit,

në procedurën penale kundër:

Haxhi Kurpalit, të birit të Dervish dhe Shake Kurpalit, i lindur më 18 gusht 1939 në Letaj, Komuna Golaj, Republika e Shqipërisë, vendbanimi i fundit i njohur në fshatin Letaj, Komuna Golaj, Republika e Shqipërisë, në paraburgim që prej datës 24 maj 2005 në Qendrën e Paraburgimit në Dubravë, Adresa e shënuar në pajtim me nenin 127 paragrafin (2) të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK) është Avokati mbrojtës Besim Morina, Rruga William Walker nr. 3, Prizren.

Duke vendosur për ankesën mbi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren P. nr. 238/04, të datës 13 prill 2007, që dënon të pandehurin për kryerjen e veprës penale të **Kidnimit** në bashkëkryerje si pjesëtar i grupit në shkelje të nenit 159 paragrafit 2 lidhur me nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) ankesë e cila është paraqitur nga avokati mbrojtës më 22 korrik 2008.


Pas dëgjimit të kërkesave të avokatit mbrojtës z. Besim Morina në prani të të akuzuarit Haxhi Kurpali dhe të mendimit dhe propozimit të Prokuroreve të ZPSK-së Znj. Anette MILK dhe Zyra ADEMI në seancën e mbajtur më 27 tetor 2009 dhe pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 27 tetor 2009.

Duke vepruar në pajtim me nenin 420 të KPPPK-së lëshon këtë

AKTGJYKIM

Ankesa e paraqitur në dobi të Haxhi Kurpalit më 22 korrik 2008 PRANOHET pjesërisht, Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren P. nr. 238/04, i datës 13 prill 2007 NDRYSHOHET sa i përket dënimit, që është ulur në katër (4) vjet e pesë (5) muaj burgim.

Sipas nenit 391 paragrafit (5) të KPPPK-së, koha e kaluar në paraburgim nga i pandehuri është e përfshirë në kohëzgjatjen e dënimit.



Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren P. nr. 238/04, i datës 13 prill 2007 në pjesët e mbetura konfirmohet.

Shpenzimet e procedurës së shkallës së dytë do ti ngarkohen të pandehurit.

Me anë të një aktvendimi të veçantë është vendosur mbi paraburgimin, në pajtim me nenet 426 dhe 393 të KPPK-së.

ARSYETIM

Historia e procedurës

1. Sami Sadullahu, pronar dhe menaxher i një kompanie në Prizren, ishte kidnapuar në lokalet e kompanisë më 8 gusht 2004, ishte dërguar në Shqipëri dhe ishte mbajtur disa ditë atje.

Kidnapuesit fillimisht kërkuan një shpërblesë prej 750.000 Euro.

Më 14 gusht 2004, pasi që i biri i tij kishte premtuar të paguajë shpërblesën, viktimja ishte liruar dhe përcjellë deri në Kosovë, ai kishte arritur në shtëpi ditën e nesërme.

Shuma prej 200.000 Euro ishte paguar më 17 gusht 2004.

Më 27 shtator 2004 njëri prej kidnapuesve, Shqiptar i Kosovës me emrin Muje Kadrijai, ishte vrarë nga sulmues të panjohur.

2. Kundër Haxhi Kurpalit, qytetar i Republikës së Shqipërisë, Prokurori publik ndërkombëtar paraqiti një aktakuzë më datë 12 maj 2006 për veprën Kidnapim të kryer në bashkëkryerje si pjesëtar i grupit në dëm të Sami Sadullahut ndodhur në Prizren prej datës 8 deri 17 gusht 2004 në shkelje të neneve 23 dhe 159 paragrafit 2 të KPPK-së. Aktakuza ishte konfirmuar me aktvendim të datës 12 maj 2006.


Gjykimi filloi më 25 janar 2007, përfshiu gjashtë shqyrtime publike dhe një seancë të mbyllur dhe përfundoi më 13 prill 2007, me shpalljen e aktgjykimit.

Haxhi Kurpali u shpall fajtor për veprën penale të Kidnapimit dhe u dënua me pesë (5) vjet burgim.

3. Gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës së Qarkut në Prizren lëshoi një urdhër arrest kundër Haxhi Kurpalit, më 19 tetor 2004, kurse më 23 nëntor 2004 PSSP-ja pranoi kërkesën e Prokurorit Publik Ndërkombëtar për letëreshtim ndërkombëtar. Haxhi Kurpali u arrestua më 24 maj 2005 në kufi në tentim për të hyrë në Kosovë dhe që atëherë ai vazhdon të jetë në paraburgim.

4. Aktgjykimi i shkruar i është dërguar të pandehurit më 21 korrik 2008 dhe avokatit të tij më 17 korrik 2008.

Avokati mbrojtës paraqiti ankesë kundër aktgjykimit më 22 korrik 2008.



5. Pas dorëzimit të lëndës te Gjyqtarët e EULEX-it në janar 2009, Gjykata Supreme e Kosovës caktoi seancën ankimore më 27 tetor 2009, ku pas raportit të gjyqtarit raportues, i pandehuri dhe avokati i tij mbrojtës sqaruan ankesën dhe Prokurori Ndërkombëtar u përgjigj siç përmendet edhe në procesverbal.

6. Këshillimi ishte bërë nga Gjykata më 27 tetor 2009.

Gjetjet e Gjykatës

I

7. Në pajtim me nenin 415 të KPPPK-së Gjykata e shkallës së dytë duhet ti shqyrtojë ex officio disa shkelje të ligjit penal dhe procedural.

Duke rezervuar për paragrafët në vijim shqyrtimin e pohimeve të ngritura nga ankesa, këtu mund të shihet se:

- nuk ka asnjë shkelje sa i përket përbërjes së Gjykatës së shkallës së parë dhe pjesëmarrjes së gjyqtarëve në shqyrtimin gjyqësor dhe në sjelljen e aktgjykimit (neni 403.1 pika 1 dhe 2), sa i përket kompetencën e kësaj Gjykate (neni 403.1 pika 6) dhe sa i përket pikave 9, 10, 11 dhe 12 të nenit 403.1 të KPPPK-së,
- shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në praninë e të akuzuarit dhe të avokatit të tij mbrojtës (neni 415.1 pikat 2 dhe 3).

II

8. Ankesa kundërshton aktgjykimin e shkallës së parë për shkak të:


- shkeljes themelore të dispozitave ligjore të KPPPK-së (neni 403),
- shkeljes së Ligjit Penal (neni 404),
- vërtetimit jo të plote dhe të gabuar të gjendjes faktike (neni 405) dhe
- vendimit mbi dënimin (neni 406).

Avokati mbrojtës propozon:

- të ndryshohet aktgjykimi i kundërshtuar dhe i pandehuri të lirohet, apo
- të anulohet aktgjykimi i kundërshtuar dhe lënda të dërgohet në Gjykatën e shkallës së parë për rigjykim, në të njëjtën kohë të caktohet përfundimi i paraburgimit, apo
- ti shqiptohet të akuzuarit një dënim më i butë.

9. Sa i përket shkeljeve substanciale të dispozitave të procedurës penale ankesa pretendon si në vijim:

- Haxhi Kurpalin Policia e kishte intervistuar në mungesë të avokatit të tij mbrojtës dhe atë e kishin kërcënuar se duhej të fliste rreth gjërave që ai nuk kishte njohuri.



Rishikimi i dokumenteve nuk konfirmon pretendimin e ankesës sepse i pandehuri Haxhi Kurpali ishte intervistuar nga Policia vetëm një herë, më 25 maj 2005 (një ditë pas arrestimit të tij) dhe në atë rast avokati i tij ishte i pranishëm.

Në shkresat e lëndës nuk ka asnjë gjurmë të kërcënimit ndaj të pandehurit.

Prandaj ky pretendim është i pabazuar.

- Në aktgjykimin e vet Gjykata e shkallës së parë nuk ka gjykuar plotësisht thelbin e akuzës (shkeljen e nenit 403 paragrafi 1 pika 7 KPPPK).

Ky pretendim nuk është shpjeguar më mirë në ankesë dhe nuk mund të pranohet. Faktikisht aktgjykimi i parë jo vetëm që shqyrtoi të gjitha elementet themelore të krimit të ngarkuar të kidnapimit, dëshmitë e lidhura me faktin dhe me përgjegjësinë e bashkëkryerësve tjerë sikur Muje Kadriaj por në mënyrë të veçantë edhe dëshmitë e lidhura me përfshirjen e të pandehurit në këtë krim, mbrojtjen e tij dhe natyrën e përgjegjesisë së tij.

Haxhi Kurpali është akuzuar për vepër penale të pjesëmarrjes në kidnapimin e Sami Sadullahut dhe Gjykata e shkallës së parë shqyrtoi tërësisht substancën e kësaj akuze.

- Aktgjykimi i parë ishte bazuar në dëshmi të palejueshme (shkelje e nenit 403 paragrafi 1 pika 8 e KPPPK-së).

Ky pretendim po ashtu nuk është provuar me mirë në ankesë dhe duket se është e pabazuar.

Faktikisht, aktgjykimi i parë nuk ishte i bazuar në dëshmi të palejueshme.

Lista e dëshmimeve e përdorur nga Gjykata është në faqen e pestë të aktgjykimit: është e përbërë nga dëshmitë, fotografitë, provat materiale, hetimet e policisë në vendngjarje, transkriptimet e bisedave telefonike, deklaratat e të pandehurit.

Dëshmitë përkatëse rezultojnë se janë mbledhur në mënyrë të drejtë.

10. Sa i përket shkeljes së ligjit penal ankesa pretendon lëshime të shumta të bëra nga Gjykata e parë pa specifikuar më mirë këtë pikë.

Kjo gjykatë e konsideron këtë pikë si të pabazuar sepse nuk mund të gjendet asnjë shkelje e ligjit penal në aktgjykimin e parë që kishte konfirmuar përgjegjësinë e të pandehurit për pjesëmarrje, si bashkëpjesëmarrës, në krimin e ngarkuar të kidnapimit.


Konceptet e përgjegjesisë penale dhe të bashkëpunimit duket se janë zbatuar drejt në aktgjykimin e kundërshtuar.

Në pajtim me nenin 159.1 të KPPK-së vepra penale e kidnapimit ndodh kur një person privohet nga liria e tij dhe kryerësi vepron me qëllim që të shtrëngojë atë apo dikë tjetër të kryejë apo të mos kryejë apo të pajtohet me një vepër.

Qëllimi i përfitimit material prej këtij krimi nuk është shprehur por mund të konsiderohet si i përfshirë në shtrëngimin e ushtruar ndaj viktimës për të kryer një vepër.

Nga formulimi i dispozitës ligjore është e qartë se krimi është i kompletuar kur personi është rrëmbyer dhe kryerësi vepron me atë qëllim specifik.

Realizimi i qëllimit nuk është i domosdoshëm për të njësuar krimin.



Qëllimi i përfitimit material nga ky krim nuk është i shprehur por mund të konsiderohet i përfshirë në shtrëngimin e ushtruar mbi viktimën për ta kryer veprën. Nga formulimi i dispozitës ligjore del e qartë se ky krim është i përfunduar kur personi është rrëmbyer dhe kur kryerësi vepron me atë qëllim specifik. Përmbushja e qëllimit nuk është e domosdoshme për ta integruar krimin.

Megjithatë, po qe se kryhet synimi i veprimit (në rastin tonë pagesa e shpërblësës), një gjë e tillë nuk mund të konsiderohet si diçka e ndarë nga krimi, por si pjesë e tij. Në rastin tonë, privimi nga liria i viktimës ka pasur si synim detyrimin e pagesës së shpërblësës në shumën prej €750,000 dhe kërkesa për këtë shpërblësë është bërë gjatë mbajtjes së viktimës (shih dëshminë e Sami dhe Ferit Sedullahut dhe letrën me kërkesën, provën materiale nr. 6).

Në këtë mënyrë, veprimi i kryerësve ka përmbajtur veprën penale me të cilën ata ngarkohen. Shpërblesa dihet se është paguar disa ditë pas lirimit të viktimës. Megjithatë, gjatë kohës së mbajtjes së viktimës, viktima dhe familja e tij kanë qenë të informuara mbi kërkesën e shpërblësës dhe i biri i viktimës tashmë kishte mbledhur ca nga të hollat. Në mbrëmje, pas lirimit të tij, viktima ishte vizituar nga Mujë Kadriaj i cili kishte arritur pajtimin me të për shumën e të hollave (€200,000) që do t'i paguante në emër të shpërblësës.


Kështu, pagesa prej €200,000 nuk mund të konsiderohet si rezultat i një krimi tjetër prej kidnapimi. Pjesëmarrja e qëllimshme në mbledhjen e parave të shpërblësës është e barabartë në krimin e kidnapimit, duke pasur parasysh faktin se personi që ka pranuar paratë ka kontribuar në arritjen e këtij rezultati të përbashkët.

Pasi që ky krim është kryer nga një grup i kryerësve, zbatohet paragrafi 2 i nenit 159 të KPPK-së.

11. Rreth pikës që ka bërë me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ankesa pretendon se nuk janë sjellë dëshmi të besueshme dhe konkrete sa i përket përgjegjësisë penale të të pandehurit. Në fakt, as viktima as dëshmitari që i morën paratë e shpërblësës (Nevahir Sedullahu dhe Shehadin Sedullahu) kurrë nuk e kanë parë të pandehurin si person të përfshirë në këtë krim.

Gjykata e shkallës së parë më shumë u ka besuar dëshmitarëve anonimë sesa këtyre të përmendur më lart, dhe kjo do të thotë se lënda është bazuar në hamendje dhe supozime. Dëshmitë e mbledhura përkufizohen si të pasakta, të paplota, të pamjaftueshme dhe të diskutueshme.

Ankesa pretendon se dëshmitë dhe fotot e përzgjedhura nga Prokurori tregojnë kryerësit si persona me mjekra dhe flokë të gështenja, përderisa bijtë e Haxhi Kurpalit, të dyshuar si kryerës, kanë flokët bionde. Për këtë arsye, dëshmitë e dëshmitarëve anonimë A dhe B nuk kanë asgjë të përbashkët me realitetin. Thirrjet telefonike të bëra nga i biri i të pandehurit nuk përmbajnë asgjë që do ta fajësonin këtë të fundit, dhe përmbajtja e tyre është abuzuar nga ana e gjykatës.



Është ende e paqartë se çfarë sjellje ka pasur i pandehuri dhe në çfarë mënyre ka marrë pjesë në këtë krim. Varfëria e skajshme e të pandehurit dhe familjes së tij është dëshmi se ai nuk ka pasur asnjë përfitim nga ky krim. Shenjë e pafajësisë së Haxhi Kurpalit është edhe kthimi i tij spontan në Kosovë. Ankesa kërkon që aktgjykimi të sillet duke respektuar dispozitat e paragrafëve 1-4 të nenit 157 të KPPPK-së.

Kjo Gjykatë konsideron se konstatimi faktik i bërë nga gjykata e shkallës së parë ka qenë i saktë dhe se dispozitat përkatëse ligjore janë zbatuar në mënyrë të plotë.

- Fillimisht duhet patjetër të vërehet se gjykata e shkallës së parë ka përjashtuar dëshminë e dëshmitarit anonim B, të dhënë para prokurorit, si dëshmi të palejueshme në përputhje me nenin 156, par. 1 të KPPPK-së. Për këtë arsye, aktgjykimi i kundërshtuar nuk është bazuar në atë dëshmi dhe pretendimet kundër tij, nuk mund të shqyrtohen këtu.

- Së dyti, mund të shtohet se asnjë shkelje e dispozitave të nenit 157 të KPPPK-së nuk mund të konstatohet për arsye se:

- dëshmitë përkatëse janë kundërshtuar nga mbrojtja qoftë gjatë fazës paraprake qoftë gjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor (neni 157, paragrafi 1);

- aktgjykimi i kundërshtuar nuk e ka shpallur të akuzuarin fajtor duke u bazuar vetëm apo në masë vendimtare në dëshmitë e të pandehurit para policisë ose para prokurorit (neni 157, par. 2), sepse dëshmitë e rëndësishme vendimtare janë gjetur mes tjerash në dëshmitë e gjyqimit, në dokumentet dhe në transkriptet e telefonatave;

- në këtë rast nuk ka pasur dëshmitarë bashkëpunues (neni 157, par. 4).


12. Ka nevojë për një shqyrtim më të saktë të dispozitës së nenit 157.3 të KPPPK-së, sipas së cilës gjykata nuk mund ta shpallë të akuzuarin fajtor duke u bazuar vetëm apo në masë vendimtare në dëshminë e dhënë vetëm nga një dëshmitar, identiteti i të cilit është anonim për avokatin mbrojtës dhe për të akuzuarin.

Në këtë rast, është e qartë se gjykata e shkallës së parë nuk ka bazuar aktgjykimin e saj vetëm në dëshminë e dëshmitarit anonim A, sepse ajo ka gjetur edhe dëshmitë tjera të rëndësishme për vërtetimin e dëshmisë së parë.

Lidhur me pjesën e dytë të dispozitës së përmendur ligjore (e cila përjashton që dëshmitari anonim të përdoret nga gjykata për dënimin e të pandehurit “në masë vendimtare”), është qenësore të përkufizohet çka është “vendimtare” për një dëshmi.

Kjo Gjykatë është e mendimit se “vendimtare” është ajo dëshmi e cila “vendos” mbi përgjegjësinë penale të të pandehurit. Me fjalë të tjera, vendimtare është ajo dëshmi pa të cilën Gjykata nuk ka mundësi apo nuk ka material të mjaftueshëm dëshmues për shpalljen fajtor të të akuzuarit. KPPPK-ja pranon dëshmitarët anonimë vetëm si dëshmi të cilat përdoren si dëshmi “shtesë” të dëshmive tjera, të cilat edhe vetë janë të mjaftueshme për dëshmimin e përgjegjësisë penale të të pandehurit.

Në këtë rast, nuk ka pasur shkelje të dispozitës ligjore të lartpërmendur. Duhet të vërehet se dëshmia themelore dhe vendimtare për dënimin e të pandehurit përbëhet nga telefonatat e datës 11 qershor dhe 2 korrik 2005, nga deklaratat e dëshmitarit dhe nga disa



pjesë të deklaratave të të pandehurve, të cilat vërtetohen nga dëshmia e dëshmitarit A, por ky vërtetim nuk është vendimtar.

Në fakt, duke lexuar transkriptet e telefonatave këto gjëra dalin të qarta:

- bashkëbisedues në njëren anë është Safet Kadriaj (zëri i të cilit është njohur nga polici i SHPK-së Selman Hoxha dhe telefonata është regjistruar në telefonin e tij), ndërsa në anën tjetër është Dervish Kurpali, përkatësisht vëllai i njërit nga kidnapuesit (Mujë Kadriaj) dhe i biri i të pandehurit Haxhi Kurpali;

- telefonatat janë bërë menjëherë pas arrestimit të Haxhi Kurpalit (24 maj 2005);
- të dy telefonatat lidhen pikërisht me krimin, me hetimet, me dëshmitë e mbledhura dhe veçanërisht me dëshminë e cila mund të arsyetojë akuzën dhe paraburgimin e Haxhi Kurpalit.

Këto dy telefonata nuk duken të jenë të motivuara vetëm nga interesimi për fatin e të pandehurit (babait të Dervish Kurpalit) por mbi të gjitha nga interesimi për rezultatin e hetimit, për mjaftueshmërinë e dëshmimeve, për gjasat që Safet Kadriaj ka mundur të flasë me organet lidhur me rolin e të pandehurit dhe në këtë mënyrë të përbënte dëshminë kryesore kundër tij.

Gjatë telefonatës së parë (11 qershor 2005), Safeti mohon t'i ketë dhënë policisë elementet për të akuzuar të pandehurin dhe sqaron ka pasur shumë mundësi që i vëllai dhe nipi i viktimës ta kenë parë fytyrën e Haxhiut në ballkonin e shtëpisë së Mujë Kadriajt ditën kur ata dy kishin sjellë paratë e shpërblësës.

Kjo gjë përbën dëshminë e parë faktike se Haxhi Kurpali ishte i pranishëm në atë shtëpi saktësisht kur u paguan paratë e shpërblësës. Ky element është vërtetuar me deklaratat e dhëna nga Nevahir Sadullahu para prokurorit dhe të konfirmuara në shqyrtimin gjyqësor, sipas të cilave atë ditë ai kishte parë një burrë dhe një femër pikërisht në ballkonin e shtëpisë së Mujë Kadriajt.

Ky element konfirmohet edhe me deklaratat e dhëna nga i pandehuri më 25 maj 2005 në polici¹ kur ai kishte përkujtuar se një vit më herët (d.m.th. në vitin 2004) ai dhe një nga të bijat e tij (Sadija) kishin bërë një vizitë në shtëpinë e Mujës, ku kishin qëndruar nja 15 minuta dhe kur kishin pirë kafe në atë ballkon të shtëpisë.

Se Haxhi Kurpali kishte qenë pikërisht në shtëpinë e Mujë Kadriajt, konfirmohet edhe me pjesën tjetër të deklaratave të të pandehurit, i cili përkujton se Muja ishte vrarë pak kohë më vonë;

- gjatë telefonatës së parë ne u njoftuam edhe për një gjë tjetër interesante: ishte Dervish Kurpali dhe disa persona që kanë lidhje me të, të cilët kanë mbajtur viktimën në një "bunker" jo edhe larg shtëpisë së Dervishit.

¹ I pandehuri e ka konfirmuar këtë fakt në shqyrtimin gjyqësor (shih shqyrtimin e datës 11 prill 2007, faqet 4, 5 dhe 7).



Ky detaj vërtetohet nga Safeti (i cili përmend “vendin ku tj e mbaje atë”) dhe konfirmohet nga Dervishi, i cili pranon se policia e kishte gjetur bunkerin, në të cilin ishte mbajtur viktimë;

Pika rreth bunkerit vërtetohet në dëshminë e viktimës Sami Sadullahu, i cili konfirmon se ishte mbajtur në një bunker gjatë robërimit. I pandehuri ka deklaruar se kishte jetuar në Shqipëri pranë kufirit me Kosovën dhe se viktimës i kujtohej se ishte sjellë përtej kufirit me Shqipërinë gjatë kohës së robërimit të tij;

- të dy folësit shtojnë disa detaje rreth versionit të dhënë në polici nga Safet Kadriaj, sipas të cilit familja Kadriaj takohej me Haxhi Kurpalin për shkak të miqësisë me Kujdes Kurpalin dhe pinin kafe së bashku.

Megjithatë, në të njëjtën kohë, Safeti pranon se dëshmitë që po dilnin në shesh nuk mund të nënçmoheshin ose të konsideroheshin si “të rastësishme”: Haxhi Kurpali ishte në shtëpinë e Kadriajt pikërisht në kohën e pagesës së parave të shpërblësës, ndërsa bunkerin ku mbahej viktimë “nuk ishte larg shtëpisë së tyre”, që d.m.th. shtëpisë së familjes Kurpali.

- Duhet patjetër të mos harrohet se edhe viktimë Sami Sadullahu (shqyrtimi i datës 1 shkurt 2007, faqet 24 dhe 26) edhe dëshmitari Rexhep Shemsedini (shqyrtimi i datës 5 shkurt 2007, faqe 9), kanë identifikuar një nga kryerësit materialë në foton e njëjtë (nr. 7) nga grumbulli i fotove të renditura (prova materiale nr. 5) dhe kjo foto ishte fotoja e Hazir Kurpalit, të birit të Haxhiut.


Telefonata e dytë konfirmon përmbajtjen e telefonatës së parë:

- Safet Kadriaj pyet për paraburgimin e Haxhi Kurpalit dhe kjo do të thotë se kjo thirrje është motivuar nga dëshira e Dervishit për të ditur mbi fatin e babait të tij, ngase ai është personi që e informon Safet Kadriajn për paraburgimin e Haxhiut;

- Dervishi merr në pyetje Safetin me qëllim të vërtetimit nëse ishte Safeti ai që kishte thënë se “plaku ishte atje dhe kishte pranuar paratë”. Safeti mbron veten vazhdimisht dhe mohon ta ketë akuzuar Haxhiun, duke sqaruar se ai ishte akuzuar nga personat që kishin sjellë paratë. Dervishi flet për akuzën, tërheq vërejtjen dhe në të vërtetë kërcënon Safetin me fjalët “mendoj se do të ishte mirë për ty ta tërheqësh atë (akuzën) njeri, sepse e di si kemi qenë njeri, nuk kemi qenë asi njerëz që ia rrasim njëri tjetrit, a po merr vesh?”

Safeti mohon përsëri dhe sugjeron që Haxhiu “nuk është dashur të pranojë se kishte ardhur t’i merrte paratë prej neve”. Dervishi përgjigjet se Haxhiu kurrë nuk do të pranojë diçka të tillë.

Është e qartë se në këtë telefonatë të dy folësit diskutojnë rreth sjelljes për të cilën akuzohet Haxhiu dhe mbi të gjitha për personin i cili ka mundur ta akuzojë atë në polici.



Edhe një herë, nga sqarimi i dhënë prej Safet Kadriajt konfirmohet se Haxhiu ka qenë i pranishëm kur janë paguar paratë e shpërblësës.

Të dy folësit insistojnë se Haxhiu nuk duhet kurrë të pranojë se kishte marrë paratë nga familja Kadriaj, por pikërisht kjo duket të jetë shpjegimi i vetëm logjik për praninë e tij atje dhe për rrezikun që të akuzohet pikërisht nga personat që kishin sjellë paratë.

Duke pasur parasysh elementet e përmendura më lart, të cilat kanë të bëjnë me përfshirjen e dy bijve të të pandehurit në kapjen dhe në mbajtjen e Sadi Sadullahut, nuk ka mundur të jetë e rastësishme që Haxhi Kurpali ishte në shtëpinë e Mujë Kadriajt pikërisht ditën kur ky i fundit kishte pranuar paratë e shpërblësës por prania e tij aty ishte qartë e lidhur me vullnetin e kryerësve që menjëherë ta marrin një pjesë të këtyre parave.

Shpjegimi tjetër për praninë e tij në shtëpinë Kadriaj, i dhënë nga i pandehuri (që i kishte bërë një vizitë shumë të shkurtër pasi Mujë Kadriaj e kishte vizituar të birin e të pandehurit në burg) nuk mund të vërtetohet në asnjë mënyrë.

- Mund të shtohet se Haxhi Kurpali ka pranuar që në ditën kur e ka vizituar shtëpinë e Mujë Kadriajt ai ka pasur një çantë të zezë apo ngjyrë hiri të mbylltë ku i ka mbajtur rrobat e palara të djalit të tij i cili ka qenë në burg. Prandaj, Haxhi Kurpali pranon se ka pasur në posedim një objekt, një çantë, e cila ka mundur të përdoret për fshehjen dhe transportimin e parave.

- Dy dëshmitarëve të cilët e kanë sjellë shpërblësën në shtëpinë e Mujë Kadriajt ju kujtohet që kanë pasur në posedim një çantë ku i kanë mbajtur paratë. Ngjyra e kësaj çante tregohet në mënyra të ndryshme nga këta dy dëshmitarë gjatë fazës së hetimeve dhe shqyrtimit gjyqësor.

Nevahir Sadullahu ka deklaruar para Prokurorit (shqyrtimi hetimor i 1 qershorit 2005, faqe 3) që qesja ka qenë e najlonit me ngjyrë të kaltër, kurse gjatë shqyrtimit gjyqësor (shqyrtimi i 5 shkurtit 2007, faqe 25) atij i kujtohej qesja e plastikës ngjyrë portokalli.

Shehadin Sadullahut (shqyrtimi hetimor i 1 qershorit 2005, faqe 4) i kujtohej qesja e plastikës, kurse gjatë shqyrtimit gjyqësor (shqyrtimi i 5 shkurtit 2007, faqe 22) i kujtohej qesja e plastikës me ngjyrë të verdhë në të portokalltë.


Këto detaje nuk mund të shihen si mospërputhje vendimtare të cilat do të mund të vinin në dyshim tregimin e këtyre dy dëshmitarëve.

Së pari, këta dy dëshmitarë thjeshtë kanë mund të gabojnë lidhur me ngjyrën e qeses, e cila ka qenë e errët/mbyllur në intervistën e parë dhe tri vjet pas krimit është bërë ngjyrë portokalli.

Së dyti dhe mbi të gjitha, çanta me para e sjellë nga dëshmitarët ka mundur të futet në çantën e zezë të të pandehurit kur është larguar nga shtëpia.

- Përfundimisht, në momentin e arrestimit të tij Haxhi Kurpali ka qenë në posedim të një letre të vogël me emrat e shkruar të Safet Kadriajt dhe të babait të tij Osman.

Kjo konfirmon në njërin anë që Haxhi Kurpali ka pasur raporte me familjen e Mujë Kadriajt.



Në anën tjetër sqarimi i dhënë nga i pandehuri (se ka pasur dëshirë që ti mbaj në mend emrat e tyre) nuk duket imponuese nëse merret parasysh se ai e ka pasur letrën me këta emra shumë muaj pas vizitës që i kishte bërë atyre personave.

Dëshmia e lartpërmendur lejon përfundimin që i pandehuri ka qenë personalisht dhe qëllimisht i përfshirë në krim, duke e luajtur rolin e prnauetit të parave të shpërblesës nga njëri prej kryerësve të tjerë, Mujë Kadrijaj.

13. Prova e lartpërmendur duhet patjetër të shtohet në dëshminë e dëshmitarit anonim "A" i cili konfirmon rolin e luajtur nga Haxhi Kurpali, atë të personit i cili ka pranuar një pjesë të shpërblesës nga Mujë Kadrijaj, në shtëpinë e këtij të fundit, ditën e njëjtë kur është paguar shpërbleja nga të afërmit e viktimës.

Kjo dëshmi përputhet me të gjitha detajet tanimë që i përmbajnë thirrjet telefonike dhe gjithashtu në deklaratën e parë të dhënë nga i pandehuri në Polici: Haxhiu është shoqëruar nga një grua e re, të dy kanë qëndruar jashtë shtëpisë së Kadrijajt në tarracë, paratë janë marrë dikur më vonë nga dy burra me një çantë e punuar nga stofë ngjyrë kafe të mbyllët ose ngjyrë të kaltër të mbyllët, këta dy burra janë larguar pas disa minutave pa çantën e tyre, dhe më vonë Haxhi Kurpali dhe gruaja e re janë larguar nga shtëpia me paratë në çantë.

Mund të konstatohet që dëshmia e dëshmitarit anonim "A" konfirmon pjesët e provave të cekura në paragrafët e mëparshëm pa u dukur vendimtare për dënimin e të pandehurit.

Për këtë arsye dispozita ligjore e nenit 157, paragrafi 4 të KPPPK-së, duket të jetë respektuar.

14. Pretendimet e mbetura lidhur me vërtetimin faktit duket të jenë të pabaza.

Këtu, karakteristikat fizionomike të djemve të të pandehurit nuk duken relevante, së pari duke pasur parasysh se të dytë kanë mundur të jenë të përfshirë në krim (Hazir dhe Dervish Kurpali) nuk kanë qenë të pranishëm në Gjykatë dhe karakteristikat e tyre fizionomike nuk kanë mundur të vërtetohen drejtpërdrejtë dhe saktësisht nga kjo e fundit. Së dyti, siç është vërejtur më herët viktimja dhe dëshmitari Rexhep Shemsedini kanë njohur njërin prej kryerësve material në fotografinë e Haxhi Kurpalit.


Së treti, gjatë thirrjes telefonike të lartpërmendur të 11 qershorit 2005, Safet Kadrijaj bisedon me Dervish Kurpalin (djali i Haxhiut) lidhur me bunkerin "ku e keni mbajtur atë", që do të thotë Dervishi ka pasur disa persona që kanë qenë të lidhur me atë.

I pandehuri ka pranuar se ka shkuar në Kosovo, posaçërisht në Gjakovë, shumë shpesh prandaj fakti që ai ka qenë i arrestuar gjatë tentativës për të hyrë në Kosovë nuk mund të paraqet dëshmi mbi pafajësinë e tij.

Duhet mbajtur në mend se ai është arrestuar më 24 maj 2005, nëntë muaj pas krimit, kur ka mundur të duket e arsyeshme të besohet se hetimet kanë mundur të pezullohen apo nuk kanë sjellë asnjë rezultat.

Përfundimisht, kushtet e vështira jetësore të të pandehurit mund të gjejnë shpjegim të ndryshëm nga ai që pretendohet nga avokati mbrojtës.

15. Ankesa e konsideron dënimin si shumë të rëndë duke pasur parasysh moshën e vjetërsisë të të pandehurit (i lindur më 1939), sjellja e tij gjatë paraburgimit dhe



përfundimisht kohën (një vit) e cila ka qenë e domosdoshme për Gjykatën e parë për ta shkruar dhe dorëzuar aktgjykimin.

Kjo Gjykatë e ndanë pretendimin e ankesës.

Gjykata e shkallës së parë i ka dhënë sjelljes së të pandehurit kualifikimin e duhur ligjor të pjesëmarrjes së qëllimshme në veprën e kidnapimit të rëndë, sipas nenit 159.2, të kryer në bashkëkryerje si anëtar i grupit sipas nenit 23 të KPPK-së.

Për këtë krim dënimi është prej një deri në 10 vjet burgim.

Dënimi konkretisht i shqiptuar ndaj Haxhi Kurpalit (5 vjet) ka parasysh rrethanat e dhunshme të kidnapimit, kërcënimet e përdorura për ta detyruar viktimën që ti paguaj kryerësit, shuma e shpërblësës.

Gjykata e shkallës së parë nuk i ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese të përcaktuara me nenin 64.1 të KPPK-së pasi që rrethanat personale të kryerësit dhe koha që ka qenë e domosdoshme për gjykimin e të pandehurit.

Kjo Gjykatë është e mendimit që rrethanat e lartpërmendura duhet të merren parasysh në dënimin me më shumë vëmendje se ajo e përdorur në aktgjykimin e kundërshtuar.

Mosha e vjetërsisë së kryerësit nuk mund të përbëjë një rrethanë rënduese siç konsiderohet nga Prokurori por rrethanë lehtësuese.

Roli i kufizuar i luajtur në krim nga i pandehuri dhe sjellja e tij gjatë gjykimit gjithashtu përbëjnë rrethanë lehtësuese.

Sa i përket kohës së procedurës gjyqësore, kjo Gjykatë tanimë ka vërejtur se sipas instrumenteve ndërkombëtare dhe posaçërisht nenit 6.1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, kohëzgjatja e “arsyeshme” e procedurës gjyqësore përfaqëson të drejtën e të pandehurit dhe obligimin e shtetit.

Që të merret parasysh është koha e përgjithshme e procedurës gjyqësore, në secilën fazë të vetme dhe në tërësi.


Është e lidhur jo vetëm me kohën në të cilën gjykimi duhet të filloj, por gjithashtu me kohën në të cilën duhet të mbaroj dhe aktgjykimi të shpallet.

Gjykimet e bëra në kohë të gjatë dhe të paarsyeshme lejojnë paraqitjen e ekuivalencës në mes së “drejtësisë së vonuar” dhe “drejtësisë së mohuar”, sepse ata e mbajnë individin për një kohë të gjatë në një situatë të pasigurisë e cila është e papajtueshme me sundimin e ligjit.

Kriteret e përcaktuara nga Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut e drejtë sipas praktikës, në mënyrë që të vlerësohet arsyeshmëria e kohëzgjatjes së lëndës zakonisht merr parasysh kompleksitetin e lëndës, sjelljen e aplikantit dhe atë të autoriteteve kompetente.

Në lëndët penale kur i pandehuri është në paraburgim koncepti i “arsyeshmërisë” është më i ngushtë, pasi që atij duhet ti sigurohet vendimi i formës së prerë sa më parë që është e mundur, që është në kohën e cila nuk e ia bënë atij praktikisht të pamundur që të kërkojë mbështetje nga alternativat si p.sh. lirimi me kusht.

Për të sjellë një vendim të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm kohor gjithashtu do të thotë që i pandehuri nuk duhet ta kaloj tërë kohën apo pjesën më të madhe të dënimit të tij në paraburgim para se ai ta marrë dënimin e formës së prerë.



Sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe legjislacionit të disa Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës, kur kohëzgjatja e procedurës gjyqësore është e “paarsyeshme” mund të rezulton në kompensim ekonomik.

Kjo lëndë nuk duket të jetë e kompleksitetit të veçantë: shkalla e parë ka qenë e lidhur me një dëshmitarë të ngarkuar me një vepër penale specifike, gjatë shqyrtimit gjyqësor janë dëgjuar tetë dëshmitarë dhe i pandehuri, gjykimi ka përfshirë gjashtë shqyrtime publike dhe një seancë e mbyllur brenda një periudhe prej më pak se tre muaj, edhe pse për shkak të pjesëmarrjes së gjyqtarëve dhe prokurorit ndërkombëtar të gjitha janë përkthyer në gjuhët angleze dhe shqipe, dimensionin e shkesave të lëndës (nëntë dosje) nuk duket të jetë e konsiderueshme, aktgjykimi me shkrim përbëhet nga njëzetetë faqe.

I pandehuri nuk ka treguar sjelle me qëllim të vonimit/zgjatjes.

Krahasuar me kompleksitetin jo të veçantë të procedurës gjyqësore dhe sjelljen jo vonuese/zgjatëse të treguar nga i pandehuri nga momenti i shpalljes së aktgjykimit të shkallës së parë (13 prill 2007) deri në momentin e pranimit të vendimit me shkrim nga shkrimorja e Gjykatës së Qarkut në Prizren (17 korrik 2008, që është pesëmbëdhjetë muaj) ka qenë e periudhë e gjatë e paarsyeshme me pasoja të cilat kanë pasur ndikim në të drejtën e të pandehurit mos ta kaloj në paraburgim pjesën më të madhe të dënimit të shqiptuar nga Gjykata e parë para se aktgjykimi të bëhet i formës së prerë dhe të ketë qasje në institucionet alternative.

Nuk është në kompetencë të kësaj Gjykate të vendos lidhur me formën e kompensimit ekonomik bazuar në vonesën e paarsyeshme të procedurës penale.

Megjithatë, kjo pikë mund të merret parasysh nën dispozitën e nenit 66, nr.2 të KPPK-së si rrethanë posaçërisht lehtësuese² e cila tregon se qëllimi i dënimit mund të arrihet duke i shqiptuar një dënim më të ulët.

Duke marrë parasysh të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 64 të KPPK-së përfshirë rrethanën lehtësuese të lartpërmendur (mosha e të pandehurit, roli i kufizuar i luajtur nga ai në krim dhe kohëzgjatja e paarsyeshme e disa pjesëve të procedurës gjyqësore) kjo Gjykatë e sheh të arsyeshme zvogëlimin e dënimit të shqiptuar në katër (4) vjet e pesë (5) muaj.

III

Aktgjykimi i shkallës së parë është ndryshuar pjesërisht sa i përket dënimit të shqiptuar ndaj të pandehurit.

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren P.nr. 238/04, të datës 13 prill 2007, vërtetohet në pjesët e mbetura.

Shpenzimet e procedurës gjyqësore të shkallës së dytë i ngarkohet ankuesit.

Koha e kaluar në paraburgim nga i pandehuri është përfshirë në kohëzgjatjen e dënimit.

Me aktvendim të ndarë është vendosur lidhur me paraburgimin e të pandehurit sipas neneve 426 dhe 393 të KPPK-së.

² Në këtë kuptim i kundërvihet aktgjykimit të lartpërmendur të kësaj Gjykate Supreme dhe aktgjykimeve të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, 9 nëntor 2007 Shkumbin MEHMETI dhe të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, 5 tetor 2007 B.M.



Sot më 27 tetor 2009.
Ap.-Kz. Nr. 345/2008



Pregaditur në Anglisht, gjuhë e autorizuar.

Kryetari ndërkombëtar i kolegjit
Emilio Gatti

Procesmbajtësja ndërkombëtare
Judith Eva Tatrai

Gjyqtar ndërkombëtar
Gerrit-Marc Sprenger

Gjyqtar Kosovar
Avdi Dinaj

Mjet ligjor

Ankimi kundër këtij Aktgjykimi nuk është i mundur (neni 430 i KPPPK-së). Vetëm kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e mundur, të paraqitet pranë Gjykatës e cila ka lëshuar vendimin në shkallën e parë, brenda 3 muajve nga dërgimi i këtij vendimi (nenet 451 – 460 të KPPPK-së).